



NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët Shqipe Qerimi, kryetare e kolegjit, Afrim Shala dhe Hashim Çollaku, anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Kimete Veseli, si procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të pandehurve SH.K. dhe N.K. që të dy nga Fushë Kosova, për shkak të veprës penale vjedhja nga neni 313 paragrafi 2 lidhur me nenet 31 dhe 77 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të të pandehurit N.K., avokates Marigona Lajqi, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.4504/2019, të datës 14 nëntor 2019, në seancën e kolegjit të mbajtur më datën 12 maj 2020, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e mbrojtëses të pandehurit N.K., avokates Marigona Lajqi, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, P.nr.4504/2019, i datës 14 nëntor 2019, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, me aktgjykimin e lartcekur, përkatësisht me aktgjykimin e ankimuar, të pandehurit SH.K. dhe N.K., i ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale vjedhja nga neni 313 paragrafi 2 lidhur me nenet 31 dhe 77 të KPRK dhe ndaj tyre, për shkak të kësaj vepre penale ju është shqiptuar, secilit veç e veç, dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, i cili dënim me pëlqimin e të pandehurve ju është zëvendësuar me urdhër për punë në dobi të përgjithshme, ashtu që ndaj secilit veç e veç janë caktuar nga 200 (dyqind) orë punë, e cila do të kryhet brenda periudhës prej 6

(gjashtë) muajve, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Janë detyruar të pandehurit SH.K. dhe N.K., që secili veç e veç, që t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor shumë prej nga 30 € (tridhjetë Euro), në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Është obliguar Shërbimi Sprovues në Prishtinë që të vendos për llojin e punës, caktimin e organizatës për të cilën dy të pandehurit do të punojnë, për ditët e javës gjatë të cilave puna të kryhet, të mbikëqyrin kryerjen e punës në dobi të përgjithshme dhe të njoftoj gjykatën për zbatimin e urdhrin për kryerjen e punëve në dobi të përgjithshme. Nëse të pandehurit, pas kalimit të kohës se caktuar nuk e kryejnë punën në dobi të përgjithshme ose atë e kryejnë vetëm pjesërisht, gjykata do ta urdhërojë dënimin me burgim, në atë mënyrë që 1 (një) ditë burgim do të urdhërohet për çdo 8 (tetë) orë pune në dobi të përgjithshme që nuk është kryer.

Të pandehurve SH.K. dhe N.K. do t'ju llogaritet në dënimin e shqiptuar koha e kaluar në paraburgim nga data 27 tetor 2019 e deri më datë 14 nëntor 2019, ashtu që për 1 (një) ditë të qëndrimit në paraburgim do t'ju zbriten 8 (tetë) orë të punës në dobi të përgjithshme.

Me aktvendim të veçantë është ndërprerë masa e paraburgimit.

E dëmtuara "IP P...", me përfaqësuesin e saj të autorizuar M.SH., për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë mbrojtësja e të pandehurit N.K., avokatja Marigona Lajqi, për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, duke i propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës që ta aprovoj kërkesën e mbrojtjes, ashtu që aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj sa i përket vendimit mbi dënimin, duke i shqiptuar të pandehurit një dënim më të butë.

Prokuroria e Apelit e Kosovës, me parashtresën PPA/II.nr.120/2020, të datës 31 janar 2020, ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtëses të të pandehurit N.K., avokates Marigona Lajqi, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, pasi mbajti seancën e kolegjit, shqyrtoj shkresat e lëndës, vlerësoj pretendimet ankimore dhe analizoj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 paragrafi 1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), konstatoj se :

- ankesa është e pabazuar.

Në ankesën e mbrojtëses së të pandehurit N.K., avokates Marigona Lajqi theksohet se gjykata e shkallës së parë nuk kohëzgjatjen e dënimit dhe nuk i ka zbatuar dispozitat e zbutjes së dënimit, duke i marrë parasysh rrethanat lehtësuese të rastit konkret. I pandehuri N.K. e ka pranuar fajësinë për kryerjen e veprës penale, i ka kërkuar falje publike të palës

së dëmtuar, duke shprehur keqardhje më rastin e ndodhur, ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprat penale të tilla, se i njëjti për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin, se edhe pse i pandehuri e ka pranuar se veprën penale e ka kryer në vazhdimësi me personat tjerë, ai kryesisht ka vjedhur gjësende bazike ushqimore, se i njëjti është mbajtës i familjes dhe ka kushte të vështira materiale. Andaj, duke u bazuar në të gjitha këto rrethana, mbrojtësja e të pandehurit, konsideron dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë është i papërshtatshëm dhe jo proporcional me veprën penale të kryer nga ana e të pandehurit. Kështu, që edhe në ankesën e paraqitur, mbrojtësja e të pandehurit N.K., avokatja Marigona Lajqi i ka propozuar Gjykatës së Apelit të Kosovës si më lart.

Edhe pse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve të ligjit penal, megjithatë kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, duke u bazuar në nenin 394 paragrafi 1 të KPP, sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar edhe në këto drejtime dhe konstatoj se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale e as shkelje të ligjit penal në dëm të të pandehurve.

Sipas vlerësimit të kolegjit penal të Gjykatës së Apelit të Kosovës, pretendimet ankimore të paraqitura në ankesën e mbrojtëses së të pandehurit N.K., avokates Marigona Lajqi janë të pabazuara. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ashtu siç parashihen në nenet 69 dhe 70 të KPRK, ndërsa në ankesën e lartcekur nuk është paraqitur ndonjë rrethanë e rëndësishme dhe e posaçme që nuk është vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë, e cila do ta arsyetonte shqiptimin e një dënimi më të butë ndaj të pandehurit. Siç rezulton edhe nga arsyetimi i aktgjykimin të ankimuar, gjykata e shkallës së parë me rastin e matjes së dënimit ndaj të pandehurit N.K. në përgjithësi i ka vlerësuar dhe i ka marrë për bazë të gjitha rrethanat lehtësuese që cekën edhe në ankesën e mbrojtëses së të pandehurit, ndërsa, nuk është gjetur ndonjë rrethanë rënduese për të pandehurin. Sa i përket pretendimeve ankimore në lidhje me zbutjen e të dënimit, kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës vlerëson se zbutja e dënimit duke u bazuar në nenin 71 të KPRK është vetëm një mundësi fakultative që e ka në dispozicion gjykata me rastin e matjes së dënimit, ndërsa duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret, një mundësi e tillë nuk është e përshtatshme për të arritur qëllimin e dënimit. Andaj, duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat të cilat i ka konstatuar dhe vlerësuar edhe gjykata e shkallës së parë dhe rrethanat tjera të rastit konkret (se vepra penale është kryer në vazhdim dhe në bashkëkryerje), kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit N.K. nga ana e gjykatës së shkallës së parë është dënim i drejtë, i ligjshëm, në harmoni me mënyrën dhe me peshën e veprës penale, me cilësitë personale të të pandehurit, me gjendjen e tij ekonomike, si dhe me shkallën e përgjegjësisë penale. Gjithashtu, kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës është i bindur se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i parashikuar me nenin 38 të KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë

rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale; të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart dhe në bazë të nenit 401 të KPP, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti i Përgjithshëm
PA1.nr.101/2020, më datën 12 maj 2020

Bashkëpunëtorja profesionale,
Kimete Veseli

Anëtarët e kolegjit:
Afrim Shala

Hashim Çollaku

Kryetare e kolegjit,
Shqipe Qerimi
